

TË SHPËRBËJMË NGËRÇIN ALBANOLOGJIK

Prof. Muharrem **ABAZAJ**
Studiues, Akademia “Rrënjët Tona”

PËRMBLEDHJE

Shkenca e Albanologjisë, e lindur gati tre shekuj më parë, ende nuk e ka përmbushur objektivin e saj për të cilin u krijua. Nuk ka arritur të zbulojë gjenezën e kombit shqiptar. Kjo mosarritje ka shkaktuar një mjegullnajë për lashtësinë e kombit tonë. Pengesa kryesore për këtë ka qenë pamundësia për të zbuluar zanafillën e gjuhës shqipe, pasi gjuha është tipari kryesor i dallimit të kombeve. Prejardhjen e gjuhës shqipe albanologët janë përpjekur të provojnë me anë të dy teyave: prejardhjen nga pellazgjishtja dhe atë nga ilirishtja. Dallimi midis këtyre dy tezave qëndron tek pranimi ose jo i vazhdimësisë pellazgo – ilire. Teza e prejardhjes së shqipes nga pellazgjishtja e sheh gjuhën shqipe si të prejardhur nga ilirishtja, por këtë të fundit, ilirishten, e sheh si të prejardhur nga pellzgjishtja. Kurse teza e prejardhjes nga ilirishtja, e sheh gjuhën shqipe të prejardhur nga ilirishtja, por kjo e fundit nuk ka lidhje me pellazgjishten.

Fjalë kyçe: ngërç, albanologjik, tezë, gjenezë, komb.

ABSTRACT

The science of Albanology, born almost three centuries ago, has not yet fulfilled its objective for which it was created. It has not managed to reveal the genesis of the Albanian nation. This failure has caused a fog for the antiquity of our nation. The main obstacle to this has been the inability to discover the origin of the Albanian language, as language is the main feature of the difference of nations. Albanologists have tried to prove the origin of the Albanian language by means of two verses: the origin from Pelasgian and the one from Illyrian. The difference between these two theses lies in the acceptance or not of the Pelasgian-Illyrian continuity. The thesis of the origin of Albanian from Pelasgian sees the Albanian language as derived from Illyrian, but the latter, Illyrian, is seen as derived from Pelzgjisht. Whereas the thesis of origin from Illyrian, sees the Albanian language derived from Illyrian, but the latter has nothing to do with Pelasgian.

Key word: cramp, albanology, thesis, genesis, nation.

HYRJE

Teza e parë, vazhdimësia pellazgo – ilire , e mbrojtur fort sidomos nga rilindasit tanë, pati një mbështetje më të madhe deri në vitet ‘50 të shekullit të kaluar, gjë që është pasqyruar edhe në tekstet shkollore të asaj kohe. Mbas viteve 50 të shekullit të kaluar, kjo tezë u hodh poshtë, duke e konsideruar si diçka imagjinare, jo shkencore. U organizuan studime të zgjeruara dhe përmes një Kuvendi Kombëtar, u miratua përfundimi sipas të cilit gjuha shqipe rrjedh nga nga ilirishtja. Ky është një përfundim shumë i drejtë dhe shumë i rëndësishëm, sepse hodh poshtë disa teori antishkencore që e shihnin kombin shqiptar si të ardhur në këto troje dhe gjuhën shqipe si një gjuhë pa trashëgimi të lashtë. U arrit në këtë përfundim duke u mbështetur në fakte dhe dëshmi reale të sjella nga fusha të ndryshme: nga historia, gjeografia, arkeologjia, gjuhësia, kultura e jetesës etj. Si fakte gjuhësore u morën një numër i konsiderueshëm fjalës të shqipes të cilat përbëjnë fondin autokton, fjalë të cilat nuk rezultojnë në asnjë gjuhë tjetër. Gjithashtu si fakte gjuhësore u sollën disa analiza etimologjike të emërtimeve të venbanimeve të lashta, të cilat kanë ardhur deri në ditët tona përmes ligjeve fonetike të gjuhës shqipe. Mirpo këto të dhëna gjuhësore nuk mjaftojnë për të provuar shkencërisht prejardhjen e shqipes nga ilirishtja, për arsyen e vetme sepse nuk u

bë e mundur zbulimi qoftë edhe i një dokumenti të vetëm të shkruar në ilirishte dhe ky të krahasohej me shqipen e sotme. Këtë pengesë shihte Çabej, kur shprehej? *“Duke pëmbledhur ç’është thënë për burimnin e shqipes, me çështjet që dalin përbrenda tij, dhe rrugët që janë ndjekur e metodat që janë zbatuar për të arritur në një zgjidhje, me një vështrim objektiv, do të thuhet se janë sqaruar disa anë, disa pika janë zbërthyer, po ky problem në thelb mbetet gjer më sot i pazgjidhur (“Hyrje në Historinë e Gjuhës Shqipe “. f.73.)* Pamundësia për të zbuluar material të shkruar në ilirishte, ka bërë që problem i prejardhjes së shqipes nga ilirishtja të mbetet ende në stadin e një përfundimi të mundshëm, por jo të provuar.

VAZHDIMËSIA PELLAGO – ILIRE

Këto vitet e fundit, falë edhe mundësisë së pakufishme për të siguruar informacion përmes internetit, shumë studjues kanë arritur të sigurojnë gjetje gjuhësore të shkruara, të cilat tregojnë se gjuha shqipe ka ekzistuar në periudha shumë të lashta. Nisur nga kjo lashtësia e madhe e ekzistencës së këtyre materialve, këta studjues kanë dalë në përfundimin se gjuha shqipe rrjedh nga pellazgjishtja. Këta studjues që mbështesin tezën pellazgjike janë vënë në shënjestër të Akademisë së Studimeve Albanologjike, duke i akuzuar se po përhapin njohuri të gabuara, jo shkencore. Për ta zgjidhur këtë ngërç albanologjik duhet provuar së pari vazhdimësia gjuhësore ilirishte – shqipe, për të cilën ka konsensus nga të dy grupimet dhe pas kësaj të kalohet tek faza e dytë, tek vazhdimësia pellago – ilire. Për fat të mirë sot ekzistojnë mundësi të plota për ta njohur realisht se si ka qenë gjuha ilirishte dhe për ta krahasuar me shqipen e sotme. Ndër mbishkrimet e shumta që kemi mundur të deshifrojmë është edhe ky mbishkrim që po paraqesim më poshtë.



Ky mbishkrim është gjetur në Ballsh dhe datohet si i shek IV p.e.s. Sigurisht që është shkruar nga banorët e asaj kohe të këtij territori. Gjuha me të cilën është shkruar ky mbishkrim është përafërsisht si gjuha e sotme shqipe. Themi përafërsisht, sepse ka edhe diferenca. Diferencat kryesore janë këto: fjalët e ilirishtes janë të gjitha njërrrokëshe, ato kanë trajta të ngurta, të pandrysheshme, pasi nuk kanë patur elemente gjuhësore si : parashtesa, prapashtesa, mbaresa, nyje. Por, duke qenë se ilirët nuk arritën të krijojnë një alfabet të veçantë për gjuhën e tyre (kjo për disa arsye, por nuk është vendi këtu të gjykohej për to), ata kanë përdorur herë alfabetin e greqishtes së vjetër herë atë të latinishtes. Në mbishkrimin në fjalë janë përdorur shkronjat e alfabetit të greqishtes së vjetër. Më poshtë po sjellim disa fjalë të ilirishtes të përdorura në këtë mbishkrim: am, at, bi(bir),xu(gjysh), ti, ik, le(lind),i(ai), ra (shkon), yt, e (je),a (asht),ko (kjo),pol (polli), men (mendje), ki (ky), ist (ishte),ar (arë), vel (vlla), ri (rri), se (sheh), et (jetë), I (Hyji), var (varr), han (folja ha, në gegënisht), fil (thirr), san (shan), fis (fis), ma (akoma), xal (gjallë), pun (punë), n (nuk), kra (krah), met (mbet), de (dhe, toka), un (unë), av (afër), etj. Edhe pse mbishkrimi ka karakter epigrafik, aty gjejmë rreth 2-3 qind fjalë të ilirishtes. Kjo gjë na mundëson të njohim edhe strukturën gramatikore të ilirishtes e cila paraqitet si skeleti i strukturës gramatikore të shqipes së sotme. Po japim shkurt përmbajtjen e këtij mbishkrimi.

“Babai me dy djemtë dhe nusen e njerit djalë, kanë shkuar të punojnë në arë. Në një moment, djali që kishte nusen aty në arë, largohet prej tyre. Ndërkaq i ati dhe djali tjetër shohin nusen që ka marrë një pozicion të dyshimtë. Ata e kuptojnë ç’ po ndodh. Nusen e kanë zënë dhimbjet e lindjes. At e bir alarmohen pa masë. (Për kohën ky do të ketë qenë turpi më i madh që mund t’i ndodhë një familjeje).

Babai i fëmijës duket e ka kuptuar se po lindte e shoqja dhe nga turpi është larguar. Gjyshi nuk mund ta përballonte dot këtë “mënxyrë” dhe vdes aty në arë. Fëmijën ia vendosin pranë. Nusen e ndajnë. Ajo shkon tek familja e babës së saj. Mbas një kohe fëmijën ia sjell aty xhaxhai djalit. E ëma e fëmijes gëzohet pa masë, por ky gëzim nuk zgjat shumë. Fëmija vdes.” Ky material gjuhësor, i shoqëruar edhe nga material të tjera që disponojmë, përbën një bazë të sigurtë për Akademinë e studimeve Albanologjike për të inicuar një diskutim me synim përcaktimin e vërtetësisë së këtyre deshifrimeve dhe për të dalë në përfundimet përkatëse. Organizimi i një diskutimi të tillë kërkon investime modeste. Mjafton një grup gjuhëtarësh të përgatitur shqiptarë, njohës të mirë të dialekteve të shqipes, për të dhënë një përfundim shterues për vërtetësinë këtyre mdeshifrimeve. Pasi të kemi arritur të njohim bindshëm ilirishten, ne kemi mundësi të kalojmë në fazën e dytë të kërkimeve tona: në përpjekjet për të provuar vazhdimësinë gjuhësore pellazgjishte – ilirishte.




Fig. – 1 Mbishkrim i gjetur në ishullin Lemnos Greqi

Edhe për të provuar një vazhdimësi të tillë, ekzistojnë mundësi reale. Edhe këtë vazhdimësi mund ta provojmë me dokumenta të shkruara. Në mbishkrimet e shumta që kemi mundur të deshifrojmë, mjaft prej tyre janë gjetur përtej trojeve ilire. Të tillë janë gjetur në territorin e Italisë (mbishkrime etruske), në territorin e Italisë së Jugur (mbishkrime mesape), në territorin e Greqisë, Maqedonisë, Bullgarisë, në ishujt e Egjeut, në territorin e Turqisë (mbishkrimet frigasë) etj. Të gjitha këto mbishkrime janë shkruar me të njëjtën gjuhë me atë ilire.




Fig. – 2 Mbishkrim i gjetur në Itali





Fig. - 3 Mbishkrim i gjetur në Turqi



Një fakt i tillë tregon se në këtë territor të gjerë në lashtësi është folur një gjuhë e përbashkët. Sipas historianëve të antikitetit ky territor në lashtësi është banuar nga pellazgët. Nga kjo dalim në përfundimin se kjo gjuhë e përbashkët e të gjithë këtyre popujve, duke përfshirë edhe ilirët, ka qenë gjuha pellazge. Shqyrtimi i vërtetësisë së këtyre deshifrimeve realizohet po nga ai grup gjuhëtarësh shqiptarë të cilët kanë shqyrtuar deshifrimet e mbishkrimeve që janë gjetur në territorin ilir, pasi, si thamë më lart, në të gjitha këto mbishkrime është përdorur e njëjta gjuhë, pellazgjishtja dhe se ilirishtja është e njëjta gjuhë, vet pellazgjishtja.

PËRFUNDIME

1. Ekziston mendimi se studime të tilla nuk mund të bëhen pa ndihmën e studjuesëve të huaj, pasi ata zotërojnë shumë gjuhë të huaja dhe në veçanti ato të vjetra.
2. Është e vërtetë se ka shumë gjuhëtarë të huaj me përgatitje të lartë shkencore, por për rastin tonë prania e tyre nuk është shumë e domosdoshme.
3. Asnjë studjues i huaj, sado i përgatitur të jetë, nuk arrin ta njohë në thellësi gjuhën shqipe, sidomos trajtat e vjetra të dialekteve të saj, aq sa i njohin gjuhëtarët shqiptarë, sepse pellazgjishta ka patur po këto trajta dialektore të shqipes, jo ato të gjuhëve të vjetra si sanskrishtja, greqishtja e vjetër, latinishtja etj.
4. Gjuhëtarët e huaj do të kenë mundësi të njohin rrenjët e gjuhëve të lashta, të cilat kanë dalë nga pellazgjishtja dhe ruhen vetëm tek gjuha shqipe.